

 <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	Politika e Cilësisë	Kodi DA-PO-001
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 1 nga 2

Politika e Cilësisë

Drejtoria e Akreditimit për të përmbushur misionin e saj ka krijuar dhe mirëmban sistemin e menaxhimit të cilësisë i cili bazohet në kërkesat e serisë së standardeve ISO 17000 dhe EN 45000.

Drejtoria e Akreditimit ofron shërbimin e akreditimit në mënyrë profesionale, të paanëshme, transparente si dhe ajo është e vetëdijshme për rolin e saj. Drejtoria e Akreditimit është pjesë e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e ekonomisë Shqiptare.

Drejtoria e Akreditimit premtion përmirësim të vazhdueshëm të performancës së saj në përputhje me standardet e sipërpërmendura.

Drejtoria e Akreditimit në pajtueshmëri me kërkesat e standardeve nuk do të ofrojë shërbime të tilla si shërbime konsultimi për të fituar apo mbajtur akreditimin apo aktivitete të tjera të cilat mund të ndikojnë në besueshmërinë dhe paanëshmërinë e saj.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë së Drejtorisë së Akreditimit është i planifikuar, i dokumentuar, i zbatuar dhe i kontrolluar. Ne kontrollojmë zbatimin e politikës së cilësisë dhe politikave të tjera nëpërmjet rezultateve të auditimeve të brendshme, kënaqësisë së klientëve dhe autoriteteve, statusit të efektivitetit të veprimeve korrigjuese dhe parandaluese, masave që rrjedhin nga rishikimi i menaxhimit, ndryshimeve që mund të ndikojnë në sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe rekomandimeve për përmirësim.

Ne jemi të ndërgjegjshëm që vetëm një staf i trajnuar dhe kompetent me eksperiencë praktike është çelsi për një performancë të përshtatshme dhe efektive të procedurave të akreditimit. Ne do të organizojmë trajnime të vazhdueshme për stafin tonë (të brendshëm dhe të jashtëm) dhe do të kontrollojmë efektivitetin e tyre.

Për realizimin e politikës së cilësisë ne kemi përcaktuar objektivat e cilësisë të cilat janë:

- Rritja e kënaqësisë së autoriteteve dhe klientëve
- Zvogëlimi i numrit të apelimeve dhe ankesave
- Zvogëlimi i numrit të veprimeve korrigjuese

 <p>Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	Politika e Cilësisë	Kodi DA-PO-001
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 2 nga 2

- Përfshirje e suksesshme e kryevlerësuesve dhe vlerësuesve teknik ne procedurat e akreditimit
- Përgatitja për zgjerimin e fushës së ofrimit të akreditimit
- Trajnimi i stafit të DA dhe vlerësuesve
- Vlerësimi i realizimit të programeve të punës dhe planit financiar.
- Krijimi i skemave përkatëse për të gjitha fushat e zbatimit të akreditimit të ofruara nga DA në përputhje me standardet përkatëse.
- Ndërtimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë së DA në përputhje me serinë e standardeve ISO 17000 dhe EN 45000

Stafi i DA është i vetdijshtëm që sistemi i menaxhimit të cilësisë duhet të zbatohet pa shmangie dhe mangësira dhe se ai do të zbatohet nga çdo person i cili është i përfshirë në aktivitetet e DA-së.

Tiranë më 12 Qershor 2006

Drejtore i Përgjithshëm